



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:054001

Datë: 13.06.2024

Numri i dokumentit: 05821249

**C.nr.1954/24**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Gazmend Ajvazi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.S dhe Z.S që të dy nga Gjilani, të cilin e përfaqëson av Hamdi Jashari nga Gjilani, ndaj të paditurës E.S nga fshati ...K. Gjilan, me objekt kontesti, vertetimin e pronsisë jashtë seancës më datë 13.06.2024 mori këtë :

**A K T V E N D I M**

**I. Konsiderohet** e tërhequr, padia e paditësve S.S dhe Z.S që të dy nga Gjilani, ndaj të paditurës E.S nga fshati ...K. Gjilan, me objekt kontesti, vertetimin e pronsisë, për shkak se nuk është paguar taksa gjyqësore dhe nuk është plotësuar padia me prova.

**II.** Pas plotëfuqishmëris së këtij aktvendimi Lënda C.nr. 1954/24, konsiderohet e kryer dhe arkivohet nga Gjykata Themelore në Gjilan. Për zgjidhjen e çështjes kontestuese, në rast se krijohen kushtet ligjore, paditësja mund të ushtroj padi të re, në kopje të mjaftuara, përmes kësaj gjykate.

**III.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

**A r s y e t i m**

Paditësit S.S dhe Z.S që të dy nga Gjilani, kanë ushtruar padi ndaj të paditurës E.S nga fshati ...K. Gjilan, me objekt kontesti, vërtetimin e pronsisë.

Lidhur me këtë çështje, gjykata paditësit, i ka shqiptuar vërejtje për pagesën e taksës gjyqësore dhe aktvendim për plotësimin e padië me prova dhe atë më dt. 12.03.2020, duke e obliguar të njëjtin, që në afat prej 7 ditësh ta paguaj shumën prej 30 € në emër të taksës për padi, si dhe në afat prej 3 ditësh ta plotësoj padinë me prova, por edhe pse përfaqësuesi i paditësve, vërejtjet i ka pranuar në mënyrë të rregullt as në afatin e caktuar sipas vërejtjes e as pas kalimit të këtij afati, nuk e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore si dhe nuk e ka plotësuar padinë me prova.

Andaj, gjykata ka konsideruar të tërhequr padinë e paditëses, konform nenit 253 par. 4 dhe 5 të LPK, pasi që në nenin përkatës shprehimisht është përcaktuar se “Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr”, si dhe sipas nenit 102 të LPK-së, është përcaktuar se “Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësja po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësja do të hidhet poshtë, e që në rastin konkret paditësi nuk ka paguar taksën në afatin e paraparë prej 15 ditësh, të dhënë në

bazë të vërejtjes së gjykatës, andaj padia e paditëses konsiderohet e tërhequr për mospages të taksës. Gjithashtu nuk është plotësuar padia me prova sipas aktvendimit të kësaj gjykatë.

Për shpenzimet e procedurës gjyqësore, gjykata vendosi konform nenit 450 të LPK-së.

Nga të cekurat më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**C.nr.1954/24, datë 13.06.2024**

**Gjyqtari,**  
**Gazmend Ajvazi**

**Udhëzim mbi Mjetin Juridik:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditë pas pranimit të këtij vendimi, përmes kësaj gjykate, në ekzemplarë të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.